



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhësi franceze dhe historia e gjuhës

Ngarkesa: 4 kredite, 30 leksione dhe 10 seminare

Viti / Semestri: Viti III, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit : Bachelor Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Francez

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Kjo lëndë synon të paqyrojë transformimin e gjuhës frënge në shekuj : epoka para galëve, pushtimi prej galëve, romanizimi i Galisë, epoka gjermanike, pushtimet e tjera barbare, gjuha romane, teksti i parë në gjuhën frënge (Betimet e Strasburgut), veprat e para në gjuhën romane, frëngjishtja e vjetër, frëngjishtja e mesjetës, frëngjishtja klasike, frëngjishtja moderne.

Objektivat e përgjithshme lëndore :

Kjo lëndë synon t'u japë studentëve të vitit të tretë të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja (Universiteti i Tiranës), një përshkrim dhe analizë përmbledhëse të zhvillimit të gjuhës frënge në shekuj (frëngjishtja e vjetër, frëngjishtja e mesjetës, frëngjishtja klasike, frëngjishtja moderne).

Objektivat specifike lëndore :

- Duke njohur zhvillimin e gjuhës frënge ndër shekuj, studentët pasurojnë kulturën e tyre të përgjithshme dhe atë gjuhësore.
- Njohja e mënyrave nëpërmjet të cilave gjuha frënge pasuroi fjalorin, zhvilloi strukturat gramatikore dhe faktorët politikë, ekonomikë e shoqërorë që ndikuan në transformimin e saj.
- Studentët njohin kontaktet e frëngjishtes me gjuhët e tjera, si edhe “planifikimin” gjuhësor.